$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: Shërbime të pastrimit si më poshtë:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Frekuenca totale	Volumet e punimeve	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1	FSHIRJA DHE PASTRIM ME PUNTORE SHESH-PARKIMI (4 herë në javë)	212	42,848	Sipas kërkesave të AK.	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
2	FSHIRJA E RRUGEVE ME MAKINERI (2 herë në javë)	106	42,848	Sipas kërkesave të AK.	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
3	Larja e sipërfaqeve me makineri me pompa me presion heqje e mbetjeve si çamçakiza ngjitëse shenja gomash etj (1 herë në 3 muaj)	4	21,894	Sipas kërkesave të AK.	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
4	LARJA E SIPERFAQEVE (1 herë në javë)	53	42,848	Sipas kërkesave të AK.	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
5	LARJA E WC (2 here në ditë)	365	91	Sipas kërkesave të AK.	12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

TERMAT E REFERENCES

Tirana Parking ka nën administrimin e saj Sheshet mbi dhe nën tokë të cilat shërbejnë për parkimin publik me pagesë në qytetin e Tiranës dhe për të cilat duhet kryer shërbimi i pastrimit.

Si më poshtë do të gjeni Sheshet mbi dhe nën tokë me të dhënat e detajuara:

- *Sheshi i parkimit pranë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi"*, me 2(dy) kabina shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 8.076 m², vende parkimi 76 dhe stacionime 20, si dhe 2(dy) kontenierë të mëdhenj mbeturinash. Fluksi mesatar ditor i lëvizjes së mjeteve në sheshin e parkimit qarkullojnë në ditë rreth 600 mjete.
- *Sheshi i parkimit te Stadiumi "Selman Stermasi"*, me 1(një) kabinë shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 2.200 m², vende parkimi 84 si dhe 7(shtatë) kosha mbeturinash. Fluksi mesatar i lëvizjes së mjeteve në sheshin e parkimit është rreth 360 mjete çdo ditë.
- *Parkimi Nëntokësor pranë Sheshit "Skënderbej"* me 1(një) kabinë shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 8.142,72 m², vende parkimi 303, dy kate hapësira parkimi, tualete me sipërfaqe 65.09 m² dhe me një fluks mesatar të lëvizjes së mjeteve rreth 1508 mjete çdo ditë.
- *Parkimi Nëntokësor "Bulevardi i Ri"* te ish Stacioni i Trenit me 2(dy) kabina shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 10.752,8 m², vende parkimi 321 dhe me një fluks mesatar të lëvizjes së mjeteve 650 çdo ditë.
- *Parkimi Nëntokësor "7 Xhuxhat" në Rrugën e Elbasanit* me 1(një) kabinë shërbimi, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4890 m², vende parkimi 140, dy kate hapësira parkimi, tualete me sipërfaqe 15m² dhe me një fluks mesatar të lëvizjes së mjeteve rreth 350 mjete çdo ditë.
- *Parkimi Nëntokësor pranë "Sheshit Italia"* me 1(një) kabinë shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 5644.7m², vende parkimi 198, dy kate hapësira parkimi, tualete me sipërfaqe 6.4m², me një fluks mesatar të lëvizjes së mjeteve rreth 300 mjete çdo ditë.
- *Parkimi Nëntokësor pranë Kopshtit Zoologjik* me 1(një) kabinë shërbimi, një kat hapësirë parkimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 2701,7 m², vende parkimi 80.
- *Sheshi i Parkimit pranë Gardës së Republikës* me 1(një) kabinë shërbimi, sipërfaqe të përgjithshme prej 444 m². Fluksi mesatar i lëvizjes së mjeteve në sheshin e parkimit është rreth 60 mjete çdo ditë.

1.1 Larja dhe dezinfektimi i koshave dhe tualeteve (WC)

1.1.1 Volumet e punimeve:

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë tualetet me sipërfaqe prej **90.60 m², 2 (dy) herë në ditë**, sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

1.2 Metodologjia:

1. Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë **2 herë në ditë** WC-të dhe koshat, si dhe do të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre.
2. Tualetet do të lahen në të gjithë sipërfaqen, duke përdorur furça dhe solucione larëse.

-
3. Për të mundësuar kryerjen e këtij shërbimi, kontraktori duhet të ketë në dispozicion një numër të mjaftueshëm koshash rezervë për të zëvendësuar çdo natë koshat e larguar për t'u larë.

1.3 Grafikët e punimeve:

1. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Operatori Ekonomik.
2. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim, për të verifikuar kryerjen e shërbimeve të sipërpërmendura, respektimin e standardeve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

1.4 Rregulla për t'u zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht pasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i koshave të mbledhjes së mbeturinave urbane, etj.

1.5 Mjetet dhe pajisjet

1. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e WC-ve.
2. Fshesa, kova, shtupa, furça plastike dhe mjete të tjera për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

2. Fshirja e shesheve dhe terminaleve me punëtorë

2.1 Volumet e punimeve:

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar për të gjithë sheshet dhe terminalët një sipërfaqe totale prej **42,848 m²**, me volumet respektive për secilin prej tyre.

Shërbimi i fshirjes me punëtorë i shesheve dhe terminaleve do të realizohet **4 herë në javë**, nga kontraktori, i cili gjithashtu do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse të parashikuara në metodologji për të gjitha sipërfaqet e përcaktuara, sipas listës së shesheve dhe terminaleve me volumet përkatëse.

2.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia:

Shërbimi i fshirjes me punëtorë konsiston në:

1. Fshirjen me fshesa të të gjitha shesheve dhe terminaleve nga punëtorët e Kontraktorit.
2. Zbrazjen e koshave, pastrimin e zonës përreth dhe mbajtjen çdo ditë të pastër të të gjithë koshave të mbeturinave brenda zonës së kontraktuar.

2.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve:

- a. Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të kryhet sipas grafikut.
- b. Në raste të veçanta, Autoriteti Kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, me qëllim kryerjen me cilësi të shërbimit.
- c. Grafikët mund të pësojnë ndryshime gjatë vitit, vetëm pas miratimit zyrtar nga Autoriteti Kontraktor, për shkak të pamundësisë së kryerjes apo ndryshimit të parkimit të mjeteve.
- d. Në grafik duhet të përcaktohen saktë:
 - Oraret e operimit për çdo shesh dhe terminal.
 - Numri i punëtorëve për çdo operacion shërbimi.
- e. Grafikët duhet të zbatohen rigorozisht nga Kontraktori.
- f. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve, respektimin e standarteve.

2.4 Rregulla për t'u zbatuar:

- a. Në asnjë rast nuk do të lejohen sheshe dhe terminale të papastruara apo mbeturina të palarguara.
- b. Operatori i shërbimit duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve të deklaruar në ofertën e tenderit.
- c. Në raste të veçanta, operatori është i detyruar të fshijë sheshet dhe terminalët më shumë se një herë pa shpenzime shtesë.
- d. Ndalohet kategorikisht ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes.
- e. Përdorimi i uniformave nga punëtorët është detyrues i kërkuar.
- f. Punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjieno-sanitare në fuqi.

2.5 Mjetet dhe pajisjet:

- a. Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi (fshesa plastike, karroca dore, lopata, etj.).
- b. Pajisjet dhe veglat e punës duhet të mbahen në gjendje të mirë dhe të pastër.

3. Fshirja e shesheve dhe terminaleve me makineri:

3.1 Volumet e punimeve:

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike të gjitha sheshet dhe terminalët e përcaktuar në zonën e kontraktuar, me sipërfaqe totale **42,848 m²**, **2 herë në javë**, sipas grafikëve të miratuar.

3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia:

- a. Fshirja do të kryhet me makina teknologjike fshirëse në të gjitha sipërfaqet e lira nga parkimi.
- b. Pas fshirjes me makineri, punëtorët do të pastrojnë manualisht çdo mbetje të mbetur nga procesi teknologjik.
- c. Segmentet ku nuk lejohet përdorimi i makinerive do të pastrohen me punëtorë.

3.3 Plani i punës dhe grafikët e shërbimeve:

- a. Fshirja do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.
- b. Grafikët përgatiten nga Operatori dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor.
- c. Në grafik duhet të përcaktohen:
 - Oraret e operimit
 - Lloji dhe itinerari i makinerive
- d. Operatori nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikëve.

3.4 Rregulla për t'u zbatuar:

- a. Nuk do të lejohen sheshe të papastruara.
- b. Fshirja me shpejtësi mbi **3 km/orë** konsiderohet e pavlefshme.
- c. Operatori duhet të ketë minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe personelit.
- d. Në raste të veçanta, shërbimi kryhet më shumë se një herë pa pagesë shtesë.
- e. Ndalohet ngritja e pluhurit gjatë procesit.

3.5 Mjetet dhe pajisjet:

- a. Makineri teknologjike të pajisura me fshesa anësore, fshesë qendrore, sistem aspirimi dhe spërkatje me ujë.
- b. Makineritë duhet të jenë konform standardeve të Bashkimit European.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të **3 (tre) viteve të fundit** financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilanci duhet të shoqërohet edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. (Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të

konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.2.4 Vërtetim i lëshuar nga shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sha, i cili konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me ujë. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit).*

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 10 të Dokumentave Standarte të Tenderit, Autoriteti/enti Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkotraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon një Drejtues teknik si Inxhinier Mjedisi të cilin duhet ta ketë në Liçensë me kualifikimet e duhura për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka të punësuar tij:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomë, kontratat e punës (të vlefshme brenda afatit të vlefshmërisë së ofertës), CV përkatëse.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetedeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetedeklarimet në formularin përmbledhës të vetedeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 20 personave, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen 3 (tre) muajt e fundit.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

2.3.4 Përvec inxhinierit të sipërpërmendur, duhet të rezultojnë të punësuar me kontrata pune të vlefshme edhe 2 (dy) drejtues mjetesh të rënda të pajisur me CAP, si personel i domosdoshëm për kryerjen e shërbimit.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 14001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 45001-2018** ose ekuivalent, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme)
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 39001 – 2012** ose ekuivalent, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Shënim: Certifikatat e mesiperme duhet te jene te leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akredimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet te jene marre te pakten 3 (tre)muaj perpara shpalljes se procedures dhe të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit (e vlefshme):

- a.Liçense e leshuar nga QKL per grumbullim dhe transportim te mbejtjeve urbane dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme,mbetje inerte dhe mbetjeve te llumrave nga gropat sepike dhe nga pastrimi i ujerave te zeza te leshuar nga QKL **Kodi III.2.B.**
- b. Licencë të lëshuar nga QKL **me kod II.8.A**
- c. Licencë të lëshuar nga QKL **DDD me kod II.8.B.**

2.3.7 Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lista e makinerive që duhet te disponoje operatori ekonomik te permbledhura ne tabelen e meposhtme:

N r.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
------	-------------------	--------	-------	--------------

1	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 4-5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6.	copë	1	Pronesi/Qera
2	Makinë teknologjike e vogël (autofshese) për fshirjen e rrugëve, të pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.	copë	1	Pronesi/Qera
3	Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 2 ton.	copë	1	Pronesi/Qera
4	Makineri pompe speciale për larje dyshemeje.	copë	1	Pronesi/Qera
5	Autobot uji për larjen me kapacitet mbajtës 9000-10000 litra.	copë	1	Pronesi/Qera
6	Makineri speciale për fshirjen e pllakave.	copë	1	Pronesi/Qera
7	Makineri fshesa korenti për sipërfaqet e brendshme (tek parkimet nentokesore).	copë	4	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje, si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar).
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e pronësisë, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, certifikatën e transportit (të vlefshme) dhe foto.
- Për mjetet me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) dhe foto duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike, pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të beje deklarin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
